



Viti i X^{-të} | Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2019

NDRIÇIMI OPTIMAL I INTERIERIT PËR PERSONAT ME DËMTIM TË SHIKIMIT

Neritan KANANAJ*

*Magjistër i Shkencave në Dizajn i Aplikuar

Adresë kontakti: kananaj.neritan@gmail.com

Përmbledhje

Objekti: Në dekadat e fundit numri i personave me dëmtim të plotë ose të pjesshëm të shikimit është rritur shumë. Është detyrë e arkitektit dhe e dizenjatorit që të krijojë një ambient të aksesueshëm edhe për këtë kategori personash, duke treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur ndaj kërkesave të tyre. Nevojat e këtij grupi njerëzish janë të një natyre specifike dhe një dizejnim i sistemit të ndriçimit për persona me shikim normal nuk u përgjigjet kërkesave të tyre. Përshtatja e sistemit të ndriçimit për persona me dëmtim të shikimit mund të arrihet vetëm nëse dizenjatori i njeh në thellësi nevojat e tyre në aspektin e dizajnit të interierit të ndriçimit. Pikërisht një tematikë e tillë tërhoqi vëmendjen tonë dhe do të jetë objekti i këtij punimi.

Qëllimi i këtij punimi është së pari, të identifikojë nevojat në sistemin e ndriçimit të banesës për personat me dëmtim të shikimit. Qëllim tjetër është të hetohet rëndësia e ndriçimit optimal të apartamentit të banimit për njerëz me dëmtime të shikimit. Gjithashtu, synohet të përcaktohet lloji i ndriçimit sipas nevojës së përdoruesit, si dhe të hetohet ndriçimi në bashkëveprim me elementet e tjera ndihmuese të dizejnimit të interierit, siç janë ngjyrat dhe teksturat e objekteve.

Metodat: Si metodologji do të përdoret metoda e dizajnit gjithëpërfshirës e kombinuar me një rast studimor. Pikënisje do të jetë gjetja dhe shfrytëzimi i literaturës teorike përkatëse. Në vijim, nga metodologjia e dizajnit me në qendër përdoruesin është marrë si rast studimi dhe vrojtimi një person i verbër. Mbledhja e të dhënave është bërë me anë të pyetjeve. Gjithashtu, është vëzhguar personi i verbër në ambientet e banesës dhe në përshtatjen e nevojave të tij në marrëdhënie me pjesëtarët e tjerë të familjes.

Rezultatet ofrojnë zgjidhje specifike për arritjen e ndriçimit optimal në banesë në përputhje

me nevojat e personave me dëmtim të shikimit. Konkretisht, përcaktohet lloji dhe sasia e duhur e ndriçimit, si dhe specifikat e tjera teknike që lidhen me të. Gjithashtu, përcaktohen natyra, intensiteti dhe kontrasti i ngjyrave që nevojiten në hapësirat e banimit të një apartamenti të aksesueshëm nga ky target grup.

Përfundime dhe sugjerime: Përdorimi i ndriçimit optimal ka rëndësi të madhe si për shfrytëzimin e ndriçimit natyral, ashtu edhe të ndriçimit artificial. Shfrytëzimi i arritjeve më të fundit në fushën e teknologjisë së ndriçimit dhe përcaktimi i ndriçimit në bazë të pikave orientuese, të përshtatur edhe me paletën e ngjyrave të mureve dhe mobilie, bëjnë të mundur rritjen e performancës së shikimit në personat me dëmtim të shikimit. Në mbyllje theksohet rëndësia e përdorimit të metodave bashkëkohore të dizajnit, si dizajni gjithëpërfshirës dhe dizajni me në qendër përdoruesin, për të arritur rezultate sa më të mira në fushën e interiorit të ndriçimit, veçanërisht për target grupin e marrë në shqyrtim.

Fjalë kyçe: *dizajn i interiorit, ndriçim, ambient i aksesueshëm, persona me dëmtim të shikimit.*

OPTIMUM INTERIOR LIGHTING FOR VIZUALLY IMPAIRED PEOPLE

Abstract

Object: In recent decades the number of people with complete or partial visual impairment has greatly increased. It is the task of the architect and designer to create an accessible environment for this category of people as well, showing due care and attention to their requirements. The needs of this group of people are of a specific nature, which means that a design of the lighting system for persons with normal eyesight does not meet their requirements. Adjusting the lighting system for the visually impaired can only be achieved if the designer knows in depth their needs in terms of interior lighting. Such a topic caught my attention and will be the subject of this paper.

The purpose of this paper is, firstly, to identify the needs in the apartment lighting system for the visually impaired. Another purpose is to investigate the importance of optimal interior apartment lighting for people with partial or full visual impairments. I will also aim to determine the type of lighting according to the user's need, as well as to investigate lighting in conjunction with other interior design auxiliary elements, such as colours and

textures of objects.

Methods: A comprehensive design method combined with a case study will be used as methodology. The starting point will be to find and use relevant theoretical literature. Based on user centered design methodology, a blind person was taken as a case study. Data collection was done by means of a questionnaire. The blind person was also observed in his home environment. Other family members were also interviewed regarding his special needs.

The results provide specific solutions for achieving optimum lighting in the apartment according to the needs of the target visually impaired person. Specifically, the appropriate type and amount of lighting was determined, as well as other related technical specifications. I have also determined the necessary intensity and contrast of colours for the living spaces of the apartment in this specific case.

Conclusions and Suggestions: Determining the optimum lighting is of great importance in terms of natural and artificial lighting. Utilizing the latest advances in the field of lighting technology and customizing lighting based on orientation points, keeping a close eye on the wall colour palette and furniture colour palette, make it possible to increase the performance of visually impaired persons. In the end, the study emphasizes the importance of contemporary design methods, such as inclusive design and user centered design, to achieve the best results in the field of lighting interiors, especially for the target group under consideration.

Keywords: *Interior Design, lighting, accessible environment, visually impaired people.*

1. Hyrje

Në dekadat e fundit numri i personave me dëmtim të plotë ose të pjesshëm të shikimit është rritur shumë, çka përbën një shqetësim për familjen, shoqërinë dhe institucionet përkatëse. Qeveritë e vendeve të ndryshme kanë krijuar një kuadër ligjor specifik për të mbrojtur këtë kategori njerëzish. Gjithashtu, janë ngritur një numër shoqatash qeveritare dhe bamirësie që t'u vijnë në ndihmë atyre. Qeveritë dhe shoqatat në ndihmë të njerëzve që e kanë humbur shikimin pjesërisht ose plotësisht ofrojnë fonde monetare, banesa, programe, etj., për t'i ndihmuar sa më shumë këta persona. Në këtë aspekt, është detyrë e arkitektit dhe dizenjatorit që të angazhohet për t'u ardhur në ndihmë këtyre personave duke krijuar një ambient të aksesueshëm, të përshtatur me kujdes sipas nevojave të këtij target grupi. Nevojat e këtij grupi njerëzish janë të një natyre specifike dhe një dizenjim

i sistemit të ndriçimit për njerëz me shikim normal nuk u përgjigjet kërkesave të tyre. Dizajni i ndriçimit, si një lloj i veçantë i dizajnit të interierit, i përshtatur për persona me dëmtim të shikimit, mund të arrihet vetëm nëse dizenjatori i njeh në thellësi nevojat e tyre në aspektin e ndriçimit. Pikërisht një tematikë e tillë tërhoqi vëmendjen tonë dhe do të jetë objekti i këtij punimi. Duke pasur parasysh që këta persona e kalojnë gati 90% të kohës së tyre brenda në shtëpi, rëndësia e kësaj çështjeje bëhet edhe më e madhe. Për këtë arsye, pikë së pari do të identifikohen nevojat specifike në sistemin e ndriçimit të banesës për personat me dëmtim të shikimit.

2. Metodologjia

Për të arritur qëllimin që i kemi vënë vetes, do të na vijë në ndihmë metoda e dizajnit gjithëpërfshirës, ku do të kombinohen rezultatet e literaturës teorike, me ato të një rasti studimi të kryer nga ne duke përdorur metodologjinë e dizajnit me në qendër përdoruesin. Studimi i procesit të dizajnit u krye duke përdorur një metodë cilësore të hulumtimit. Sa i takon rastit studimor, është intervistuar dhe vrojtuar një person i verbër në ambientet e banesës dhe është vëzhguar se si përshtaten e nevojat e tij të shikimit në banesë, duke pasur parasysh që në familje ka dhe pjesëtarët e tjerë.

Intervista u bë ballë për ballë dhe pyetjet u zhvilluan sipas pyetësorit të formuluar për specifikat e personave të verbër. Me anë të kësaj interviste arritëm të kuptojnë në mënyrë konkrete dhe të qartë nevojat specifike të një personi të verbër në lidhje me ndriçimin interier. Kjo na orientoi pastaj në procesin e hartimit të strategjisë së ndriçimit të përshtatshme për të. Metodologjia e dizajnit me në qendër përdoruesin, e cila nevojitet për të grumbulluar, analizuar dhe interpretuar informacionin e marrë nga intervista. Me këtë njohuri dhe metodologji si pikënisje, dhe me shqyrtimin e literaturës për ndriçimin dhe specifikën e tij për njerëzit me dëmtim të shikimit, bëhet i mundur përcaktimi sa më i mirë i llojit dhe cilësisë së ndriçimit. Parimet e dizajnit gjithëpërfshirës u patën parasysh në përcaktimin final të dizajnit interier për target grupin e marrë në shqyrtim.

3. Ndriçimi për personat me dëmtim të shikimit

Me rënien e numrit të lindjeve, sidomos në vendet e zhvilluara, por edhe në vendin tonë, ne përballemi me problemin e plakjes së popullsisë. Si rrjedhojë, me shtimin e personave të moshuar rritet edhe numri i personave me dëmtim të shikimit. Me rritjen e moshës, shikimi vjen duke u dobësuar dhe nevoja për një ndriçim më të përshtatshëm për shëndetin rritet.

Syri i njeriut e humb ndjeshmërinë me kalimin e moshës dhe korneja zverdhët, prandaj në përgjithësi syri i një shtatëdhjetëvjeçari mund të kërkojë deri në tri herë më shumë dritë në krahasim me syrin e një njëzetvjeçari për të njëjtën performancë vizuale. Jo vetëm kaq, por syri humbet edhe

fleksibilitetin, kështu që përshtatja ndaj niveleve të ndriçimit kërkon më shumë kohë.

Drita që hyn në retinë te syri i një personi të vjetër është më e përhapur si gjerësi spektri dhe kjo bën që objektet të dallohen më me vështirësi sepse zvogëlohet kontrasti. Për të kuptuar më mirë si funksionon syri, po sjellim si paralelizëm shembullin e një lenteje të aparatit fotografik. Lentja e aparatit është shumë e ndjeshme, ka shpejtësi në fokusim dhe arrin mprehtësinë e objektit të dëshiruar. Lentet dhe aparatet fotografike janë bërë duke imituar ndërtimin e syrit njerëzor. Nëse syri ynë humbet ndjeshmërinë nga plakja dhe konsumimi, atëherë qartësia e objektit bie. Duke mos qenë në fokus, këndet dhe cepat e objekteve zbehen. Po ashtu, ngjyrat zbehen e s'kanë qartësinë dhe forcën e duhur për shkak të mënyrës së shpërndarjes së dritës në retinë. Sipas Trust (2013): *“Çdonjëri ka nevojë për një nivel të mirë të shikimit dhe me rritjen e moshës këto nevoja rriten. Drita që hynë në sy fokusohet tek retina nga pas syrit, i cili ia transmeton imazhin vizual trurit. Sa më shumë syri ynë plakët, më pak dritë hynë në retinë. Shumica e njerëzve të të gjashtëdhjetave kanë nevojë për trefishin e dritës sesa kur kanë qenë në të njëzetat.”*^[1]

Duke marrë parasysh ndryshimet e moshës mesatare në botë, ndryshojnë si nevojat, dhe prioritetet. Dizajni gjithëpërfshirës e ka të detyrueshme t'i tregojë kujdesin e duhur target grupit që kërkon vëmendje të posaçme në lidhje me ndriçimin në të ardhmen, pikërisht personave me dëmtim të shikimit. Me lindjen e problemit, automatikisht kërkohet edhe zgjidhja e tij. Njeriu gjithmonë synon dhe lufton të arrijë më të mirën e mundshme. Sjellim në kujtesë fjalët e Ban Ki-moon, i cili shprehet se *“Në vitin 2050, numri i personave të moshuar në vendet e zhvilluara do të jetë dy herë më i madh se numri i fëmijëve, ndërsa numri i të moshuarve në vendet në zhvillim pritet të dyfishohet. Kjo tendencë do të ketë efekte të thella në shumë vende dhe individë.”*^[2]

Nga këto parashikime, në bazë të statistikave, ndryshon edhe mënyra përshtatjes së sistemit të ndriçimit. Përshtatja e ndriçimit është e nevojshme që personat të jenë në gjendje të kryejnë veprimet e përditshme normalisht dhe pa rrezikuar shëndetin. Kjo për arsye se rënia e shikimit rrit frikën e rrëzimit, ul aftësinë për punë, për lexim, për të parë televizor, për të drejtuar makinën, etj.

Po ashtu, përdorimi i kompjuterave, telefonave dhe i të gjitha pajisjeve teknologjike që dëmtojnë shikimin, e ka rritur numrin e personave me dëmtim të shikimit. Kjo ka bërë që nevoja për t'iu përgjigjur këtij grupi njerëzish të bëhet më e madhe dhe të marrë një vëmendje të veçantë.

Nga zhvillimi i teknologjisë, cilësia e ndriçimit artificial në ditët e sotme është rritur pozitivisht si në performancë, ashtu edhe në kursimin e energjisë elektrike. Ka një larmi zgjedhjesh sipas dëshirës dhe nevojës, dhe kjo mundëson edhe përdorimin e ndriçimit më të përshtatshëm edhe për njerëzit me dëmtim të shikimit. Kërkesa dhe nevoja për ndriçim të ndryshëm në ambiente të ndryshme dhe kontrolli sa më i mirë i ndriçimit i ndihmon njerëzit me dëmtim të shikimit të lëvizin dhe të orientohen, dhe mbi të gjitha, i bën ata të ndihen më të sigurt. Nevoja për ndriçim të mirë

është jo vetëm për lëvizshmërinë, por edhe për nevoja të tjera, siç është leximi dhe veprime që kërkojnë saktësi. Ashtu siç përcaktohet edhe në CABE (2008): *“Cilësia e ndërtesës dhe e hapësirës ndikon shumë në cilësinë e jetës së njeriut. Vendimet në lidhje me projektimin, planifikimin dhe menaxhimin e vendeve mund të përmirësohet ose të kufizojë ndjenjën e përkatësisë. Mund të rrisë ose zvogëlojë ndjenjën e sigurisë, të zgjerojë ose ngushtojë kufijtë, të promovojë ose të zvogëlojë lëvizshmërinë, dhe të përmirësojë ose të dëmtojë shëndetin. Mund të heqin realen duke imagjinuar barriera ndërmjet komuniteteve dhe mund të nxitësin të kuptuarin dhe bujarinë e shpirtit.”* [3]

3.1. Kuadri ligjor për personat me dëmtim të shikimit

Numri i të verbërve në botë arrin në 253 milionë, sipas Shoqatës Botërore të të Verbërve, e cila është një organizatë botërore që përfaqëson njerëzit dëmtim të plotë apo pjesërisht të shikimit anembanë botës.^[4] Anëtarët janë të organizuar në 190 vende, ku organizatat ndërkombëtare tregojnë kujdes në lidhje me personat me dëmtimit të shikimit. Më 3 maj 2008, Kombet e Bashkuara miratuan një konventë për personat me aftësi të kufizuara. Kjo konventë u ratifikua nga 20 shtete dhe u vlerësua nga OKB-ja si traktati më i rëndësishëm për të drejtat e njeriut në fushat sociale, politike, ekonomike dhe kulturore të shek. XXI. Vetë Kofi Annan e konsideroi këtë konventë si një arritje historike për 650 milionë njerëz me aftësi të kufizuara në botë, përfshirë 200 milionë fëmijë me aftësi të kufizuara, shumica e të cilëve jetojnë në vendet në zhvillim. Konventa e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara u firmos nga vendi ynë më 22 dhjetor 2009, e cila u ratifikua në dhjetor 2012 dhe i vendosi qeverisë detyrime të reja për zbatimin dhe realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ku bëjnë pjesë edhe personat me humbje të pjesshme ose të plotë të shikimit.^[5]

3.1.2. Statusi i të verbrit dhe legjislatura shqiptare

Legjislacioni shqiptar përcakton statusin ligjor të personave që konsiderohen të verbër dhe u siguron atyre mbështetje sociale. Ky ligj mundëson mbështetje sociale për *“të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale. Neni 7 përcakton se këshillat e Rregullimit të Territorit dhe organet e urbanistikës nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët e mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë mbajtur parasysh përshtatjet e nevojshme”*.^[6] Siç shihet, kësaj kategorie personash u është dhënë vëmendja e duhur edhe në shtetin shqiptar.

3.1.3. Numri i të verbërve në vendin tonë

Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë vlerëson se komuniteti i të verbërve në vendin tonë arrin në 10 000 persona, të cilët njihen si të tillë të tillë në bazë të kritereve mjeko-ligjore.^[6] Sipas mjekut okulist, numri i personave me dëmtim të shikimit mendohet të jetë mjaft i madh, pasi janë disa kategori sëmundjesh që çojnë në ulje të shikimit, deri në verbim, siç janë: glaukoma, katarakta, diabeti, etj. Grupmosha më e prekur janë mbi 50 vjeç, por rezulton se edhe grupmoshat e fëmijëve kanë probleme të konsiderueshme në lidhje me nivelin e shikimit.^[7] Gjithsesi, nga kërkimi arritëm në përfundimin se ende nuk ka të dhëna të sakta për sa i përket numrit dhe specifikave të njerëzve me dëmtim të shikimit. Shpresojmë që në të ardhmen të mund të sigurohet të dhëna të tilla, me qëllim që të mund t'i ofrohej ndihmë më e madhe kësaj kategorie personash.

4. Ndriçimi i apartamentit për njerëz me dëmtim të shikimit

Me termin *dëmtim të shikimit* specialistët u referohen jo vetëm personave që në një moshë të caktuar (p.sh., në fëmijëri, në rini, në moshë të mesme, etj.) kanë pësuar humbje të pjesshme ose të plotë të shikimit për shkak të një sëmundjeje ose aksidenti, por edhe atyre personave që për shkak të moshës pësojnë rënie graduale të shikimit në mënyrë të natyrshme dhe jo për shkak të një sëmundjeje, siç ndodh te moshat e vjetra. Kjo kërkon që në një shtëpi ku banojnë dy pleq të përshtatet një lloj tjetër ndriçimi nga ajo e një familjeje të re. Po ashtu, një person që është në moshë të re, por ka humbur një pjesë të konsiderueshme të shikimit, ka nevojë për përshtatje të veçantë të sistemit të ndriçimit në banesën e tij.

Duke qenë se përshtatja e ndriçimit varet edhe nga kategoria e personit me dëmtim të shikimit dhe secili rast kërkon një vëmendje më vete, u përdor metodologjia e dizajnit me në qendër përdoruesin. U mor një individ i verbër si rast studimi dhe iu bënë pyetje në lidhje me ndriçimin më të përshtatshëm që mund ta ndihmonte në rritjen e cilësisë së shikimit. Nga përgjigjet e marra, si dhe nga eksperimentimet me ndriçimin, por edhe nga përvoja e të verbërit, u bë e qartë nevoja për një ndriçim të mirë e të bollshëm.^[8]

Shfrytëzimi sa më i mirë i dritës natyrale do të ishte idealja për rastin studimor. Drita natyrale do të duhej të kompensohej me ndriçimin artificial. Ndriçimi nevojitet të jetë i bollshëm dhe me shpërndarje njëtrajtshme. Kjo nevojë e rastit të studimit është e aplikueshme jo vetëm për këtë person, por për të gjitha rastet ku dëmtimi i shikimit është në shkallë të madhe. Duke pasur parasysh se këta persona zakonisht jetojnë në familje, atëherë jemi të detyruar të mendojmë në kuadër të dizajnit gjithëpërfshirës.

4.1. Ndriçimi natyral në interior

Arkitektë të njohur botërorë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë rolit të ndriçimit në banesë. Siç ka thënë edhe arkitekti i njohur Louis Kahn, “Një dhomë nuk është dhomë pa dritën natyrale.”^[9] Vetë Kahn njihet për veçantinë e përdorimit të dritareve në “Fisher House”, të cilat bënin të mundur futjen e dritës natyrale dhe ruanin njëkohësisht edhe privatësinë. Shumë dizenjatorë kanë bërë punë të mirë në lidhje me dizajnin e ndriçimit. Një prej tyre është edhe Richard Kelly, i cili bëri emër si pionier kualitativ i dizajnit të ndriçimit në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar. Kelly e konsideron dritën e ambientit si formën e parë dhe themelore të dritës. Ai e konsideron këtë formë drite si ndriçim të përgjithshëm të mjedisit, që bën të dukshëm hapësirën, objektet dhe personat që janë rreth nesh. Sipas Granslandt (1912), kjo formë e përgjithshme dhe uniforme e ndriçimit bën të mundur orientimin tonë.^[10]

Shfrytëzimi në maksimumin e mundshëm të dritës së diellit në ambientin e banimit është një nevojë e domosdoshme, si për shëndetin në lidhje me shikimin, por edhe me trupin tonë në tërësi, jo vetëm për personat me dëmtim të shikimit, por për të gjithë njerëzit. Njeriu përdor hapjet e dritareve për të lejuar dritën e diellit të hyjë në banesë dhe të kryejë funksionet që i nevojiten. Nevoja për privatësi dhe intimitet është një kërkesë që imponon reduktimin e këtij ndriçimi me anë të përdorimit të perdeve të errëta apo me punim të dendur. Shfrytëzimi sa më i mirë i dritës natyrale në apartamente nuk është më një përparësi. Duke izoluar dritaret me perde të padepërtueshme të dritës, lind nevoja të përdorim ndriçimin artificial. Kjo nuk është as e shëndetshme për njeriun, por edhe nuk mundëson ruajtjen e energjisë. Për të mbajtur dritaret me perde të hapura, një zgjidhje ofrohet nga grilat me komandim këndi dhe niveli të dritës, duke e kontrolluar sasinë e dritës së diellit dhe duke eliminuar vezullimin e rrezeve të forta. Me përdorimin e tyre zgjidhet edhe problemi i privatësisë, shmanget izolimi me perde të ngarkuara që izolojnë dritën dhe lejohet drita e diellit të hyjë në banesë. Kjo mënyrë gjithashtu ruan njeriun nga dëmtimi i rrezeve jo të shëndetshme të diellit. Që të hyjë sa më shumë dritë natyrale në banesë, xhamat e dritares nevojitet të mbahen të pastra. Po ashtu, duke qenë se niveli i dritës natyrale ndryshon në varësi të stinës edhe motit, si edhe në varësi të orëve të ditës, është e rëndësishme që drita elektrike të përshtatet në mënyrë të tillë që të kompensojë mungesën e dritës natyrale. Një zgjidhje tjetër është edhe hapja e dritareve në pjesën e sipërme, p.sh. në pjesën e tavanit ose në lartësinë e mureve, të cilat fusin dritën edhe ruajnë privatësinë e ambientit të shtëpisë.

4.2. Ndriçimi në marrëdhënie me ngjyrat dhe objektet

Personi të verbër të marrë si rast studimor iu bënë një varg pyetjesh hulumtuese të parapërgatitura paraprakisht në format anketimi. Pyetjet kishin lidhje me ndriçimin e apartamentit të tij dhe përgjigja

që morëm ishte se atij i nevojitej një ndriçim i bollshëm, që ndriçimi mos të ishte i përqendruar vetëm në një pikë por në disa drejtime, në mënyrë që të ishte sa më uniform. [8] Personin do ta ndihmonte një kontrast i fortë që arrihet nëpërmjet dritës dhe ngjyrave. Gjithashtu, ndriçimi të një i verbër luan edhe rolin orientues. Me përdorimin e materialeve që reflektojnë dhe shkëlqejnë në dritë, të vendosura në këndet e mobileve apo mureve, arrihet të krijohet një hartë vizuale që e ndihmojnë atë për orientim. [8]

Nga biseda e gjatë me personin në fjalë, arritëm të kuptojmë se muret nevojitet të jenë me ngjyrë të lehtë dhe tavani gjithmonë i bardhë, që mos të shkaktojnë vezullim të dritës dhe të mos pengojnë qartësinë e objekteve. Boja nevojitet të jetë pa shkëlqim, si për muret, dhe mobiliet. Tekstura e mobilieve dhe e dyshemesë nuk duhet të jetë e ngarkuar sepse krijon vështirësi për të dalluar këndet e mobilieve dhe objektet. Këto e vështirësojnë shikimin dhe e lodhin, por mund të sjellin edhe aksidente gjatë lëvizjes. Për t'u dalluar dhe për të krijuar kontrast, dyert nuk duhet të jenë në të njëjtën ngjyrë me muret. Edhe dyshemeja duhet të ketë ngjyrë tjetër, në mënyrë që të bëjë kontrast me muret. Krijimi i kornizës me një ngjyrë tjetër i evidenton muret dhe dyshemenë edhe më tepër. Doreza e derës duhet të ketë edhe ajo ngjyrë ndryshe nga dera, madje ngjyrë më të fortë. Çelësi i kontrollit të dritës duhet të jetë pranë dyerve hyrëse edhe të ketë ngjyrë të fortë. Ideale do të ishte nëse çelësi do të luante dhe funksionin e kontrollit të ndriçimit sipas forcës së dëshiruar. Aq sa është e rëndësishme cilësia e ndriçimit, po ashtu është e rëndësishme edhe paleta e ngjyrave të mobilimit të interierit. Diferencim në ngjyrë duhet të bëhet midis të gjitha ndarjeve për të krijuar kontrast dhe kufij të qartë.

4.3. Lloji i ndriçimit artificial dhe cilësia

Ndriçimi i fortë, i përqendruar në një burim drite të vetme, krijon rrezatim më të fortë dhe të dëmshëm për syrin e njeriut, veçanërisht për njerëzit me probleme të shikimit. Ata bëhen më të ndjeshëm ndaj rrezatimit dhe kërkohet një distancë e mjaftueshme e largësisë së dritës nga syri i njeriut. Këto lloj rrezatimesh krijojnë perceptime të gabuara për orientim për të verbrin. Nevojitet një kombinim i llojeve të ndryshme të ndriçimit, i përshtatur sipas nevojave specifike të personit. Nuk ekziston një mënyrë universale e ndriçimit për të gjithë personat me dëmtim të shikimit. Gjithsesi, këta persona zakonisht jetojnë me familjarë të tjerë, prandaj duhet që interieri i ndriçimit të bëhet sipas parimeve të dizajnit gjithëpërfshirës. Një mundësi është shtimi i numrit të llambave, pra të mos vendoset një llambë e vetme, por disa. Gjithashtu, mund të përdoret jo një abazhur me një llambë të vetme, por të vendoset me një i tillë me disa krahë ndriçimi. Niveli i dritës kërkohet të jetë më i lartë se më parë. Nëse etapat e njerëzimit në marrëdhënie me ndriçimin fillojnë nga drita e zjarrit, pastaj vijon me dritën e kandilave me vaj, e më tej te ndriçimi i kohëve tona me energji

elektrike, vihet re një rritje e nivelit të dritës. Njeriu gradualisht ka rritur nevojën për dritë sa më të mirë, siç ilustron në Figurën 1.



Fig. 1. Historiku i llojeve të ndriçimit^[11]

Llambat inkandeshente që përdoren në masë dikur, sot përdoren më rrallë, pasi harxhojnë shumë energji dhe jetëgjatësinë e kanë të vogël. Nëse duhet sot të rrisësh numrin e tyre për të rritur cilësinë e ndriçimit, ato nuk janë idealet, pasi llambat ekonomike i konkurrojnë ato. Llambat ekonomike, për të shfrytëzuar më mirë energjinë, harxhojnë pesë herë më pak se ato inkandeshente. Këto llamba, nëse janë 20W (1,070 lumen), kanë ndriçim të bollshëm. Llambat ekonomike janë disa llojesh. Llambat fluoreshente, siç janë tubat e neonit, harxhojnë pesë herë më pak dhe nuk nxehen shumë. Llambat halogjene kanë ndriçim më të dobët, por janë shumë cilësore. Përdorimi i dritave led në ditët e sotme e ka rritur cilësinë e ndriçimit. Ndriçimi me led, i cili përbëhet nga një bashkësi diodash, krijon ndriçim të mirë dhe me shpërndarje të njëtrajtshme të dritës. Si fitues i çmimeve për vitin 2016 qëndron teknologjia led, në të cilën janë integruar sensorë, komandim i ngjyrave, bëhet ulja dhe rritja e forcës së ndriçimit, etj. Prirja për teknologjinë led u dëshmuar qartë në ekspozitën e 27-të vjetore të panairit të dritave “*The 2016 Lightfair Innovation Awards*”, mbajtur për herë të parë në San Diego, ku u bënë 275 parashtresa për produktin, të organizuara në 15 kategori. Fituesit, nga një për çdo kategori, me tre prej atyre që u përzgjodhën për nderimet më të larta të programit, plus një dizajn inovativ të paraqitur në citate, gjithçka e teknologjisë LED, ofruan zhvillim të vazhdueshëm sensorëve të integruar dhe aftësive të akordimit të ngjyrave.^[12]

4.4. Përdorimi i llambave që kanë nivel më të lartë ndriçimi

Sasia totale e ndriçimit të emetuar nga një burim drite matet me lumen, ndërsa vatët tregojnë sasinë e energjisë që përdor një burim drite. Rritja e fuqisë së ndriçimit në lumen, shtimi i numrit të llambave dhe dizajni për një shpërndarje më të mirë të dritës, duke vendosur ndriçim në mur, në dysheme, në tavolinë, në kënde apo tek mobiliet, krijon mundësi më të mira për shikimin. Llambat janë më të mira për syrin kur janë me ngjyrë të ngrohtë. Ato kanë shenjë dalluese dhe cilësohen si të ngrohta nëse fillojnë nga numri referues 2700 Kelvin, që tregon temperaturën e dritës. Për pjesën më të madhe të njerëzve rekomandohet kjo ngjyrë drite. Në Figurën 2 ilustron një model i tillë. Temperatura e dritës së një llambe përshkruhet në rangun 1000 K deri në 10000 K. Kështu, llambat për banesa dhe për qendra tregtare rekomandohen nga 2000 K deri në 6500 K. Shifrat referuese të ngjyrës së temperaturës së llambës tregojnë ngjyrën e dritës që emeton llamba. 2000 K deri 3000 K cilësohet si llambë e ngrohtë, praktikisht një ngjyrë e qetë dhe e rehatshme pasi shtrihet në spektrin ngjyrë e verdhë deri në ngjyrën e verdhë në të bardhë. Ky lloj ndriçimi rekomandohet për dhomë ndenjeje, kuzhinë, dhomë gjumi, banjë, restorant, ambient tregtar dhe zbukurime dekorative të jashtme. 3100K deri në 4500K është ngjyrë e bardhë e ftohtë. Llambat me këtë spektër emetojnë dritë të fortë vibruese me ngjyrë të bardhë më neutrale dhe me nuancë të lehtë blu. Ky lloj ndriçimi sugjerohet për bodrume, garazhe, mjedise pune dhe abazhur leximi. Ngjyra e ftohtë blu varion nga 4600 K deri në 6500 K. Ky lloj ndriçimi përafrohet me dritën natyrale të ditës. Llambat me këtë spektër janë shumë të fuqishme. Llambat e kësaj natyre janë më të përshtatshme për ekspoziturë, për drita sigurie, etj.



Figura 2^[13]

[14]

Nga shkalla e dëmtimit të shikimit, varet edhe lloji i llambës sipas ngrohtësisë në Kelvin. Një i verbër, si në rastin konkret studimor që ka një humbje të shikimit me 99%, i nevojitet maksimumi i dritës së ftohtë që imiton atë të dritës ditën me 6500 K. Por për njerëzit e tjerë ky lloj ndriçimi është shumë fortë dhe jo rrallë i padurueshëm. Duke zëvendësuar llambat e dikurshme inkandeshente me rezistencë të cilat harxhonin energji, me llambat ekonomike led, cilësia e ndriçimit ndikon pozitivisht në jetën e personave me dëmtim të shikimit.

Ndriçimi i mirë rrit kontrastin dhe qartësinë e shikimit. Ndriçimi duhet të japë iluminim të njëtrajtshëm duke shmangur hijet dhe zonat e errëta. Niveli i dritës duhet të jetë i ngjashëm edhe në dhomat e tjera të apartamentit që syri mos të lodhet për t'u përshtatur nga ndryshimi i nivelit të dritës. Zonat që janë më të prirura për aksidente, si: shkallët, tualeti dhe kuzhina e gatimit, duhet të kenë një nivel ndriçimi më të përshtatur.

Për të zbutur shkëlqimin e fortë të llambave, duhen përdorur veshje të cilat e shpërndajnë dritën uniformë dhe më të zbutur për syrin e njeriut, p.sh. një formë globi material i përshtatshëm për të përhapur energjinë pa e penguar atë. Shtimi i numrit të llambave në pika dhe kënde të ndryshme e bën ambientin e banimit më të ndriçuar, më cilësor dhe shmang zonat e errëta e hijet.

5. Përfundime dhe sugjerime

Përdorimit të ndriçimit optimal në banesë për personat me probleme të shikimit i duhet dhënë rëndësia e duhur, si për shfrytëzimin e ndriçimit natyral, ashtu edhe të ndriçimit artificial. Duke shfrytëzuar arritjet më të fundit në fushën e teknologjisë së ndriçimit, mund të përcaktohet ndriçimi në bazë të pikave orientuese, duke e përshtatur edhe me paletën e ngjyrave të mureve dhe të mobilieve. Në këtë mënyrë performanca e shikimit të personat me dëmtim të shikimit rritet dhe ua bën atyre lëvizjen dhe veprimet më të lehta dhe më të sigurta. Rrjedhimisht, edhe cilësia e jetës së tyre përmirësohet. Metoda e dizajnit me në qendër përdoruesin jep orientim shumë të mirë për të kuptuar nevojat e personave me probleme të shikimit, por për të arritur rezultate sa më të mirë në interiorin e ndriçimit duhet menduar në kuadër të dizajnit gjithëpërfshirës, pasi nevojat për ndriçim në banesën e një familjeje ndryshojnë sipas grupmoshave dhe problemeve specifike të personave. Është e rëndësishme që arkitektët dhe dizenjatorët në vendin tonë t'u kushtojnë rëndësi këtyre metodave bashkëkohore të dizajnit, me qëllim që të arrihet të përmirësohet cilësia e jetës së përdoruesve, por edhe për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës në këtë fushë.

Referenca

- [1] Trust, Th. P. Lighting Solution Guide: Improve the Lightning in your home. 2013. <https://www.rnib.org.uk/sites/default/files/Lighting%20Solutions%20guide%202013-14.pdf>. Aksesuar më 22 janar 2019.
- [2] Ki-moon, B. Ageing in the 21st Century. <https://www.helpage.org/resources/ageing-in-the-21st-century-a-celebration-and-a-challenge/ageing-in-the-21st-century-preface-by-ban-kimoon/> Aksesuar më 24 nëntor 2019.
- [3] Comission for Architecture and the Built Environment (CABE). Inclusion by design: quality, Diversity and the Built Environment. 2008. <https://www.designcouncil.org.uk/sites/default/files/asset/document/inclusion-by-design.pdf>. Aksesuar në 8 shkurt 2018.
- [4] World Blind union (WBU). Who we are. <http://www.worldblindunion.org/English/Pages/default.aspx>. Aksesuar në 12 shkurt 2018.
- [5] Swiss agency for development and Cooperation SDC, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë &

- United Nations Albania. Programi i Kombeve të Bashkuara për mbështetjen e përfshirjes sociale në Shqipëri. Raport i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara . Prill 2016. [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/raporti%20perputhshmerise%20legjislacionit%20shqiptar%20me%20kpda%20\(prill%202016\).pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/raporti%20perputhshmerise%20legjislacionit%20shqiptar%20me%20kpda%20(prill%202016).pdf). Aksesuar në 12 maj 2018. Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë VSH. Historiku i SHVSH. <https://www.shvsh.org.al/historiku>. Aksesuar në 20 janar 2018.
- [6] Republika e Shqipërisë Kuvendi. Përmbledhje legjislacioni për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore. Për statusin e të verbërit. Ligji Nr. 8098, datë 28.3.1996. <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/6.pdf>. Aksesuar në 18 shkurt 2018.
- [7] Numri i të verbërve rritet, mjekët apel shqiptarëve: Pas të dyzetave vizita e detyrueshme. Opozita.com, 14 tetor 2017. <http://www.opozita.com/2017/10/numri-te-verberve-rritet-mjeket-apel-shqiptareve-pas-te-dyzetave-vizita-e-detyrueshme>. Aksesuar në 10 shkurt 2018.
- [8] Çela, E. Intervistë me person me dëmtim të shikimit. 11 dhjetor 2017. Intervistues Neritan Kananaj.
- [9] Kahn, L. I. The making of a room. 1961. <http://www.arthistory.upenn.edu/themakingofaroom/catalogue/section7.htm>. Aksesuar në 10 mars 2018.
- [10] Rüdiger Ganslandt, H. H. Handbook of Lighting Design. Germany: Verlag Vieweg. 1992.
- [11] Foto nga internet që ilustron historikun e llojeve të ndriçimit. <http://www.oznium.co.za/led-lights/e27-led-replacement-bulb/> Aksesuar në 3 prill 2018.
- [12] Architectural Lighting Industry. The 2016 Lightfair Innovation Award Winners. [usa.lighting.philips.com](http://www.usa.lighting.philips.com): http://www.archlighting.com/industry/the-2016-lightfair-innovation-award-winners_o. Aksesuar në 24 janar 2018.
- [13] Fotografi e bërë nga Neritan Kananaj për të treguar një model llambe led me të dhëna në lumen dhe vat. Fotoja është bërë zgjedhje rastësore.
- [14] Becker, D. Color Measurement. In Color Trends and Selection for Product Design, 2016. Science Direct, Elsevier Inc. Available online 17 June 2016. <https://doi.org/10.1016/B978-0-323-39395-9.00037-2>



SHKENCAT SHOQËRORË

SEKSIONI 3

